



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-28277/24 datë: 23.10.2024



Npi – 01/342 datë: 31.10.2024

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), Nenin 17 shkronjat (a) dhe (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 13 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Nenin 17 të Rregullores së (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; Kuvendi i Komunës, shqyrtoi Propozim-Vendimin e Kryetarit të Komunës së Shtimes Nr.02/1107 të datës 24.10.2024 për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme komunale, dhe duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/335 të datës 29.10.2024, në seancën e mbajtur më 31.10.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE NË ZONËN KADASTRALE - DAVIDOVÇ

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -X- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 31.10.2024, me shumicën e votave miratoi, vendimin për formimin e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale, në Zonën Kadastrale – Davidovc, Ngastra Kadastrale me numër P-72809023-00333-16, me sipërfaqe prej 2894m², vendi i quajtur - Utrinë, Pronari - Komuna e Shtimes. Periudha kohore e dhënies në shfrytëzim 99 vite.

Komisioni është zgjedhur në këtë përbërje:

1. Halil Kurtishi – nga ekzekutivi komunës,
2. Shqiprim Hyseni – nga ekzekutivi komunës,
3. Artan Lubovci – nga Kuvendi (pozita),
4. Reshat Mujota – nga Kuvendi (opozita),
5. Imer Tershana – nga organizatat joqeveritare, (Klubi i Biznesit – Shtime)

II

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të parapara në nenet: 5, 6, 7, 8, 15, 16, 19, 20 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të Komisionit, Kryetarit të Komunës, Drejtorive, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi